



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government Of Kosovo
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë
Institut za Zlocine Pocinjene Tokom Rata na Kosovu
Institute of Crimes Committed During the War in Kosovo



Politika e Privatësisë

1. E drejta e privatësisë;

E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave tuaja personale janë prioritete me rëndësi të veçantë për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL). Instituti angazhohet që të përpunojë të dhënat tuaja personale me përgjegjësi, transparencë dhe drejtësi, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18616>), si dhe me rregulloren përkatëse të Bashkimit Evropian (BE) për mbrojtjen e të dhënave (GDPR), aty ku është e zbatueshme, (<https://gdpr.eu/what-is-gdpr/>).

Kjo politikë e mbrojtjes së të dhënave personale zbatohet nëse jeni aplikant për punë, palë kontraktuese, merrni pjesë në një trajnim të organizuar nga ne, vizitoni selinë ose faqen zyrtare të Institutit, përdorni ndonjë nga shërbimet tona, ose paraqisni kërkesë përmes e-mailit apo faqes sonë të internetit. ([IKKL – Instituti i krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë](#))

2. Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?

Përpunues i të dhënave personale është, **Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë- Zyra e Kryeministrit.**

Adresa: Rruga Arbënor e Astrit Dehari, nr.25, 10000 Prishtinë, Kosovë, tel: 038 200 14 930 Email: info.ikkl@rks-gov.net

Zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale: **Bleona Maxharraj**

email: bleona.maxharraj@rks-gov.net

3. Kategoria e të dhënave që përpunojmë?

Në varësi të qëllimeve dhe kërkesave ligjore, Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë përpunon të gjitha ose disa nga të dhënat personale të mëposhtme, ndaras ose në kombinim ndërmjet tyre:

- Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, gjinia, data e lindjes, të dhënat e dokumenteve të identitetit;
- Të dhënat e kontaktit: adresa e banimit, e-maili, numri i telefonit;
- Të dhënat profesionale: arsimi, kualifikimi profesional dhe veprimtaria e punës;
- Të dhëna shëndetësore (vetëm kur kërkohen nga ligji);
- Të dhëna të tjera sipas ligjeve që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose kontratat;
- Foto dhe video nga konferenca ose ngjarje zyrtare.

4. Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat tuaja personale?

Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, i themeluar me Ligjin Nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, përdor të dhënat tuaja personale për qëllime të qarta, të ligjshme dhe të nevojshme për realizimin e funksioneve të tij si institucion publik, agjenci në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Qëllimet e përpunimit përfshijnë: zbatimin e detyrimeve ligjore dhe administrative; menaxhimin e marrëdhënieve të punës dhe të përzgjedhjes së stafit; menaxhimin e komunikimeve dhe të shërbimeve online; përgjigjen ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike; promovimin e aktiviteteve përmes publikimeve në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale; si dhe botimin dhe shpërndarjen e informacionit për qëllime edukative, kërkimore dhe të informimit publik.

5. Baza ligjore për përpunim;

Përpunimi i të dhënave personale nga Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë bazohet në legjislacionin përkatës të Republikës së Kosovës, përfshirë Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjin Nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, si dhe aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e këtij ligji, i cili përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Institutit në ushtrimin e funksioneve të tij. Përpunimi i të dhënave personale realizohet gjithashtu në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE). Në disa raste, ne përpunojmë të dhënat personale vetëm pas pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave, i cili mund të tërhiqet në çdo kohë nga subjekti i të dhënave.

6. Me kë i ndajmë të dhënat personale të mbledhura?

Instituti ndan të dhënat personale me autoritetet kompetente, siç janë institucionet e sigurisë, organet gjyqësore dhe autoritetet mbikëqyrëse, të cilat, në bazë të një akti juridik, kanë autoritetin të kërkojnë nga Instituti të dhëna personale për subjektet e caktuara, në përputhje me procedurat zyrtare.

7. Cilat janë të drejtat tuaja?

Kur të dhënat tuaja personale përpunohen nga Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, ju keni këto të drejta:

- E drejta e qasjes – në të dhënat tuaja personale dhe, në çdo kohë, të kërkonti korrigjimin ose përditësimin e tyre pa vonesë, nëse të dhënat tuaja janë të pasakta ose jo të plota;
- E drejta e fshirjes (e drejta për t'u harruar) – keni të drejtë të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja personale dhe, në rrethana të caktuara, të kërkonti kufizimin ose ndalimin e përpunimit të tyre;
- E drejta për njoftimin e palëve të treta – keni të drejtë të kërkonti që çdo korrigjim, fshirje apo kufizim i përpunimit të të dhënave tuaja t'u komunikohet palëve të tjera, të cilave u janë zbuluar të dhënat tuaja personale;

8. E drejta e ankimit;

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale ka të drejtë të paraqes ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Ankesa mund të paraqitet në adresën: Rr. Zejnel Salihu, nr. 22, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. (Web www.aip.rks-gov.net).

9. Siguria e të dhënave personale;

Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë zbaton masa të përshtatshme fizike, organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat tuaja personale, në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave personale varet nga qëllimet e përpunimit për të cilat ato janë mbledhur dhe përcaktohet sipas ligjeve përkatëse. Ruajtja dhe arkivimi i tyre bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërore, si dhe me Ligjin Nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë dhe me aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e këtyre ligjeve.

10. Përditësimi i Politikës së Privatësisë;

Instituti mund ta përditësojë periodikisht Politikën e Privatësisë. Çdo ndryshim apo përditësim i politikës do të bëhet i disponueshëm në mënyrë transparente në faqen zyrtare të Institutit dhe palët e interesuara do të njoftohen në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me dispozitat ligjore. Ky proces garanton që të dhënat personale të përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në çdo kohë, duke mbrojtur në mënyrë efikase privatësinë dhe të drejtat e palëve.

11. Përdorimi i cookies;

Ky njoftim përshkruan mënyrën se si Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës përdor cookies kur ju ndërveproni me ne përmes faqes sonë zyrtare të internetit. Përdorimi i cookies është një praktikë e zakonshme në internet dhe shërben për të përmirësuar funksionimin dhe sigurinë e shërbimeve online.

Cookies janë skedarë të vegjël tekstualë që përmbajnë një sasi të kufizuar informacioni dhe ruhen në pajisjen tuaj elektronike, si kompjuter, telefon i mençur apo tablet, gjatë vizitës në faqen tonë të internetit. Këta skedarë mund të mbledhin informacione lidhur me mënyrën e përdorimit të faqes nga ana juaj.

Ne përdorim cookies për qëllime funksionale dhe analitike, duke përfshirë mundësinë për të njohur preferencat tuaja (si p.sh. gjuha e përzgjedhur), për të siguruar funksionimin teknik dhe sigurinë e faqes, si dhe për të përmirësuar përvojën tuaj gjatë navigimit.

Informacionet e mbledhura përmes cookies përdoren në mënyrë anonime dhe vetëm për qëllime statistikore dhe përmirësim të shërbimeve tona, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Prishtinë, Mars 2026